



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/311
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201900165/2

Tiranë ___/___/2019

Lënda : Rekomandim për trajtimin e rastit të nëpunësit civil z. F. D

Drejtuar : DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

TIRANË

DREJTORISË RAJONALE TATIMORE

FIER

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit është regjistruar një ankesë nga nëpunësi civil z. F.D, ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore (DRT) Fier, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), për mosmiratim pa të drejtë të kërkesës për leje një mujore pa të drejtë page. Pas regjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, konstaton se:

Rasti plotëson kushtet për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, pasi ankuesi është shtetas shqiptar, nëpunës civil, subjekti ndaj të cilit ai ankohet është organ i administratës publike, dhe objekti i ankesës është një veprim i paligjshëm i kësaj të fundit.

Për sa më lart, bazuar në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, nenet 13, 17/a dhe 18/a , ka vendosur t'a pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes duke ndërmarrë një proces hetimi administrativ.

Rrethanat e rastit

1. Ankuesi është nëpunës civil me detyrë inspektor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier. Prej fillimit të muajit janar të vitit 2019 ai ndodhet në shtetin Grek, duke u kujdesur për nënën e tij. Prej 6 muajsh ajo është në gjendje mjaft të rëndë shëndetësore. Për muajin janar 2019 ai ka përfituar pushimin vjetor sipas pikës 2 të Kreut II të Vendimit nr. 511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", i ndryshuar. Me

përfundimin e afatit të kohëzgjatjes së pushimit vjetor të paguar, më datë 22.01.2019 ankuesi i është drejtuar me një e-mail zyrtar Drejtuesve të DRT Fier, përkatësisht Drejtorit Rajonal z. Oltion Caku dhe Drejtorit të Funksioneve Mbështetëse z. Julian Grëmbi, si më poshtë:

Une inspektori F.D ,aktulisht jam Greqi ,edhe per disa muaj mamaja ime eshte ne gjendje te rende shendetesore,eshte ne spital ne Greqi,per kete arsye me duhet leja pa te drejte page nga data 31.01.2019 deri 27.02.2019, jam personi i vetem ne familje me te,sepse prinderit i kam te divorcuar .

2. Më datë 28.01.2019 Drejtori i Funksioneve Mbështetëse në DRT Fier, z. Julian Grëmbi, i ka kthyer përgjigje ankuesit, për dijeni Drejtorit Rajonal të DRT Fier, z.Oltion Caku, dhe Përgjegjësit të Sektorit të Vlerësimit të Punonjësve në DPT, z. Ilir Kurti, si më poshtë:

Pershendetje !

Ne pergjigje te kerkeses tuaj ju bejme me dije se nuk ju miratohet leja pa te drejte page per arsye te ngarkeses ne pune.

Faleminderit!

3. Ndodhur në këto rrethana, në pamundësi për t'u kthyer në detyrë, ankuesi më datë 30.01.2019 i është drejtuar me e-mail një numri subjektesh, ndër të cilët Drejtori i Funksioneve Mbështetëse dhe Drejtori Rajonal i DRT Fier, Zv.Drejtori i Përgjithshëm i DPT, Drejtori i Përgjithshëm i DPT, Përgjegjësi i Sektorit të Vlerësimit të Punonjësve në DPT, Avokati i Popullit, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, duke kërkuar pezullimin nga shërbimi civil për shkak të gjendjes shëndetësore të nënës së tij:

Ne baze te kerkeses qe kam bere ne daten 22.01.2019 , duke me kthyer pergjigje negative ne daten 28.01.2019 duke ditur problemin tim . Une s'mund ta le dot mamane time vetem ne gjendje kritike per jeten e saj .

Ne baze te ligjit Nr. 152/2013 PËR NËPUNËSIN CIVIL (Ndryshuar me ligjin nr, 178/2014, datë 18.12.2014, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 211) ,Neni 55 Pezullimi me kërkesë të nëpunësit (Shtuar fjalët në pikën 2 me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014) PIKA 2. Nëpunësi civil mund të pezullohet me kërkesë të motivuar të tij edhe për shkak të një interesi tjetër të ligjshëm të tij sipas përcaktimeve të vendosura nga Këshilli i Ministrave, për një periudhë deri në 2 vjet.

Une i nenshkruari F.D inspektor i pare ne Drejtorine Rajonale Tatimore Fier , ne keto rrethana qe jam kerkoj pezullimin .

4. Siç rezulton nga e-mail i datës 31.01.2019 i z. Ilir Kurti, Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit të Punonjësve në DPT, kërkesa e datës 30.01.2019 e nëpunësit civil për miratim të pezullimit nga shërbimi civil për shkak të gjendjes shëndetësore të nënës së tij, është refuzuar me arsyetimin e mëposhtëm:

Në lidhje me kërkesën e dërguar me e-mail me datë 30.01.2019, për pezullim nga shërbimi civil, për një periudhë deri në 2 vjet, ju bëjmë me dije se, në respektim të dispozitave ligjore në fuqi: ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i

ndryshuar, VKM nr. 124, date 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, i ndryshuar (pika 2/b; pika 5; pika 10/c; pika 11; pika 12/a; pika 13 etj), nëpunësi duhet të njoftojë zyrtarisht me kërkesë me shkrim, njësinë e burimeve njerëzore (Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve), brenda afateve të përcaktuara për interesin e ligjshëm për miratimin e pezullimit. Kërkesa e nëpunësit duhet të jetë e arsyetuar dhe e vërtetuar me dokument të lëshuar nga institucioni shëndetësor brenda ose jashtë vendit, me qëllim që të shqyrtohet dhe merret në konsiderat nga njësia përgjegjëse.

Nisur sa më sipër, ju njoftojmë se kërkesa juaj nuk miratohet.

5. Për shkak të refuzimit nga njësia përgjegjëse në DPT për miratimin e pezullimit, ankuesi më datë 04.02.2019 i është drejtuar sërish me e-mail një numri subjektesh, ndër të cilët Drejtori i Funkcioneve Mbështetëse dhe Drejtori Rajonal i DRT Fier, Drejtori i Përgjithshëm i DPT, Përgjegjësi i Sektorit të Vlerësimit të Punonjësve në DPT, Avokati i Popullit, etj, duke përsëritur, arsyetuar dhe dokumentuar kërkesën e tij për pezullim nga shërbimi civil:

Ne vijim te e-mail tim te meparshem permes se cilit i jam drejtuar nder te tjera edhe njesise se burimeve njerzore prane DPT e cila sipas pikes 13 te Kreut I te VKM 124/2016 eshte njesia pergjegjese per miratimin e pezullimit te nepunesit civil me kerkese te ketij te fundit, pas marrjes se pergjigjes negative nga ana juaj, pra njoftimit per mosmiratimin e kerkeses per pezullim, ju drejtohem serish me kerkese dhe sqarime si me poshte vijon:

Sic jeni ne dijeni mamaja ime eshte ne gjendje shendetesore kritike per jeten dhe po kurohet ne Greqi. Per shkak te gjendjes sone familjare une jam i vetmi person i aferm qe mund te kujdeset per te. Ndaj dhe qe prej fillimit te muajit janar, bazuar ne lejen vjetore 1 mujore te miratuar jam prane saj duke u perkujdesur per te, gje per te cilen nese ka dyshime mund te vertetohet si nga vulat ne pasaporte ashtu dhe nga rekordet ne sistemin TIMS.

Duke qene se afati i lejes vjetore perfundon dhe une nuk kam mundesi te kthehem ne pune per arsye te gjendjes se renduar shendetesore te mamase sime, me date 22 janar 2019 jam drejtuar serish me nje kerkese per te kerkuar miratimin e lejes 30 ditore pa te drejte page, sipas pikes 10 te VKM Nr. 511, datë 24.10.2002. Kjo kerkese e imja nuk eshte miratuar.

Ne keto kushte, duke mos pasur asgje zgjidhje tjeter, pasi nuk mund te braktis njeriun me te shtrenjte te jetes sime, kerkoj nga njesia e burimeve njerezore prane DPT miratimin e pezullimit per nje periudhe 3 mujore. Kjo kerkese bazohet ne piken 2 te nenit 55 te ligjit nr. 152/2013 “Per nepunesin Civil”, si edhe ne germen “c” te pikes 10 dhe germen “a” te pikes 12 te Kreut I te VKM nr.124/2016:

Pika 2 e nenit 55:

2. Nëpunësi civil mund të pezullohet me kërkesë të motivuar të tij edhe për shkak të një interesi tjetër të ligjshëm të tij sipas përcaktimeve të vendosura nga Këshilli i Ministrave, për një periudhë deri në 2 vjet.

Germa “c” e pikes 10 te Kreut I te VKM nr.124/2016:

10. Nëpunësi civil me kërkesën e tij mund të kërkojë pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil në këto raste:

...

c) Për shkak të një interesi tjetër të ligjshëm, për një periudhë deri në 2 vjet, sipas përcaktimit në pikën 12, të këtij vendimi.

Germa "a" e pikes 12 te Kreut I te VKM nr.124/2016:

12. Kërkesa që paraqet nëpunësi civil për rastin e parashikuar në shkronjën "c", të pikës 10, të këtij vendimi, duhet të jetë e motivuar. Ai mund të bëjë kërkesë për pezullim për rastet e mëposhtme:

a) Për arsye shëndetësore të tij apo të njerëzve të afërm të tij, të vërtetuar me dokument të lëshuar nga institucioni shëndetësor brenda ose jashtë vendit;

...

Per sa me lart, kerkesa ime eshte e motivuar pasi sic ju thashe une kam mamane ne gjendje kritike shendetesore. Kete kerkese time e verteton dokumenti bashkelidhur ketij email. Ky dokument eshte vertetimi i leshuar nga institucioni shendetesor, dhe eshte perkthyer e noterizuar ne menyre te rregullt.

Ju lutem te me kthehet nje pergjigje sa me shpejt, duke qene se sic ju thashe afati i lejes se zakonshme ka perfunduar dhe nuk dua qe gjithe kjo suate te behet shkak per tu konsideruar si veprim i parregullt nga ana ime, apo mungese e pajustificuar ne pune, e cila mund te me penalizojë duke me kushtuar edhe vendin e punes. dokumentat orgjinale me perkthim edhe noterzim jane derguar me zarf per ne DPT.

6. Kërkesa e dytë e z. F.D për pezullimin nga shërbimi civil ka bashkëlidhur edhe dokumentin e lëshuar nga institucioni shëndetësor, raport i gjendjes shëndetësore të pacientes M.R, firmosur dhe vulosur nga mjeku që e ka lëshuar (siç rezulton nga përkthimi zyrtar i dokumentit). Këto dokumente janë dorëzuar edhe zyrtarisht në DPT, me nr. protokollit 2227 date 05.02.2019

7. Siç rezulton nga e-mail i datës 05.02.2019 i z. Ilir Kurti, Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit të Punonjësve në DPT, kërkesa e dytë, ajo e datës 04.02.2019 e nëpunësit civil për miratim të pezullimit nga shërbimi civil për shkak të gjendjes shëndetësore të nënës së tij, është refuzuar me arsyetimin e mëposhtëm:

Në përgjigje të kërkesave tuaja të përsëritura, ju rikonfirmojë se, nuk miratohet pezullim nga shërbimi civil për periudhën 3 mujore, për shkak se nuk përmbush kushtet e përcaktuara në VKM nr. 124, date 17.02.2016 "Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil", i ndryshuar (pika 2/b; pika 5; pika 10/c; pika 11; pika 12/a; pika 13 etj), si dhe Ligjin nr. 152/2013 "Per nepunesin civil" i ndryshuar.

Ju sjellë në vëmendje se, kërkesa nuk është në respektim të afatit dhe në formën e përcaktuar në dispozitat ligjore. Dokumentacioni i paraqitur nuk mund të konsiderohet dokument zyrtar, pasi nuk është në formën e kërkuar nga ligji.

Kërkesa juaj për pezullim nga shërbimi civil për një periudhë 3 mujore nuk vërtetohet, për sa më sipër.

8. Pranë Avokatit të Popullit ankuesi ka deklaruar si më poshtë:

Aktualisht jam ne Greqi prane mamase,para 6 muaj asaj i ra nje krize cerebrale ne koke,me pasoje mosecjen normale edhe te veprimeve te komunikimit,ajo jeton ketej e vetme,per kete arsye mora leje nje mujore te zakonshme kete vit ,duke ardhur ne Greqi pasi qe shendeti i saj eshte renduar shume edhe po merem me dokumenat ketej se doktorat nuk po me japin nje zgjidhje ...

Vlerësimi i Avokatit të Popullit, konkluzione dhe rekomandime

Ankuesi, i cili është nëpunës civil pranë DRT Fier ka kërkuar të përfitojë nga një e drejtë që të gjithë nëpunësve civil u njihet nga legjislacioni i posaçëm në fuqi që rregullon çështjet e kohës së punës dhe të pushimit, përkatësisht pika 10 e Kreut II të Vendimit nr. 511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, i ndryshuar (në vijim VKM 511/2002). Kjo dispozitë parashikon, citojmë:

10. Nëpunësi civil ka te drejte, qe, ne raste te veçanta, te kërkojë leje pa te drejte page, për arsye shëndetësore, personale, për fëmijët, bashkëshortin apo prindërit. Kohëzgjatja e kësaj leje përcaktohet nga drejtuesi i institucionit, me propozimin e eprorit te drejtpërdrejtë. Kohëzgjatja maksimale e te gjitha lejeve te papaguara, brenda një viti kalendarik, nuk mund te jete me e gjate se 30 dite.

Nga rrethanat që ankuesi ka parashtruar rezulton se ai është i vetmi person që mund të kujdeset fizikisht për nënën e tij për shkak se prindërit janë të divorcuar.

Në vendimmarrjen e DRT Fier, sipas pikës 2 të rrethanave të rastit në këtë rekomandim, nuk është marrë parasysh kërkesa e ankuesit, as gjendja psikologjike e rënduar e tij, dhe as gjendja shëndetësore e nënës, por është konkluduar në mënyrë direkte me mosmiratimin e lejes.

Kërkesa e nëpunësit civil është legjitime, në kuadër të një interesi të ligjshëm të tij, siç është e drejta e kujdesit shëndetësor për nënën. Nga ana tjetër, vendimmarrja e organit publik në këtë rast nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, parim i cili qëndron në themelin e veprimtarisë së organeve të administratës publike.

Zbatimi i parimit të proporcionalitetit gjatë ushtrimit të veprimtarisë publike nënkupton se në çdo rast masat apo vendimet e marra nga organet publike duhet të jenë të tilla që të balancojnë sa më shumë të jetë e mundur interesat publike dhe ato të personave privatë. Ky parim kërkon krahasim dhe balancë midis synimeve apo qëllimeve të një veprimi nga njëra anë, dhe ndikimin kufizues ndaj palës tjetër. Rëndësia e të drejtave ose interesave të prekura ose të përfshira nga njëra anë, dhe të drejtat ose interesat publike që duhet të prmbushen, nga ana tjetër, duhet të vlerësohen siç duhet nëse ligji ka lënë hapësirë për të zgjedhur ndërmjet dy ose më shumë opsioneve.

Në rastin konkret ligji ka lënë hapësirë për të zgjedhur, duke qënë se ai i ka njohur nëpunësit civil të drejtën për të përfituar leje pa të drejtë page, në rast të një interesi të ligjshëm të tij. Nga ana tjetër vendimmarrja e organit publik Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, nuk është proporcionale me interesin legjitim të ankuesit. Ky organ nuk ka arsyetuar dhe as nuk ka provuar se interesat institucionalë për shkak të ngarkesës në punë, prevalojnë mbi interesin personal të ankuesit për kujdes shëndetësor ndaj nënës së tij.

Për këto arsye vlerësojmë se vendimi i datës 28.01.2019, për mosmiratim të lejes për shkak të ngarkesës në punë, është një vendim i pa arsyetuar dhe si rezultat rekomandojmë që qëndrimi duhet të rishikohet.

Për shkak të veprimit të mësipërm, siç rezulton në pikat 3 dhe 5 të rrethanave të rastit, ankuesi më datë 30.01.2019 dhe 04.02.2019 ka kërkuar miratimin e pezullimit nga shërbimi civil, bazuar në ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar (në vijim ligji nr. 152/2013), nenet 53, pika 1 gërma “b” dhe 55 pika 2, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 17.02.2016, “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” i ndryshuar (në vijim VKM 124/2016), pikat 2/b, 10/c, 11, 12/a dhe 13 të Kreut II.

Sipas dispozitave të mësipërme, rastet dhe procedura për miratimin e kërkesës për pezullim të nëpunësit civil për shkak të një interesi të ligjshëm të tij janë si më poshtë vijon:

- Pezullimi i marrëdhënies në shërbimin civil bëhet me kërkesë të nëpunësit civil për shkak të një interesi të ligjshëm, çka nënkupton ndër të tjera edhe arsye shëndetësore të tij apo të njerëzve të afërm të tij, të vërtetuar me dokument të lëshuar nga institucioni shëndetësor brenda ose jashtë vendit;
- Kërkesa për pezullim i drejtohet me shkrim 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës së kërkuar për pezullim, njesisë së burimeve njerëzore;
- Pas kërkesës së nëpunësit civil, njesia e burimeve njerëzore brenda 10 ditëve kalendarike miraton ose jo pezullimin, e në rastet e mosmiratimit vendimi duhet të jetë i arsyetuar.

Të dy kërkesat e nëpunësit civil për miratim të pezullimit nga shërbimi civil për shkak të një interesi të ligjshëm, janë refuzuar nga njesia përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas sqarimeve në pikat 4 dhe 7 të rrethanave të rastit. Në rastin e parë, kërkesa e nëpunësit civil është refuzuar, me arsyetimin se ajo duhet të dërgohej **me shkrim, brenda afateve, e të ishte e arsyetuar dhe e vërtetuar me dokument të lëshuar nga institucioni shëndetësor**. Në rastin e dytë, kërkesa e nëpunësit civil është refuzuar me arsyetimin se ajo **nuk ishte në respektim të afatit, nuk ishte në formën e përcaktuar në dispozitat ligjore, dhe se dokumentacioni i paraqitur nuk mund të konsiderohej dokument zyrtar pasi nuk ishte në formën e kërkuar nga ligji**. Për të gjitha këto arsye, struktura përgjegjëse pranë DPT ka konkluduar se kërkesa e ankuesit për pezullim nuk mund të vërtetohet.

Avokati i Popullit vlerëson se kërkesa e dytë e ankuesit, ajo e datës 04.02.2019 (sipas pikës 5 të rrethanave të rastit), përmban të gjithë elementët e formës së kërkuar nga VKM nr. 124/2016:

Kërkesa është **me shkrim, i drejtohet njesisë përgjegjëse** (njesia e burimeve njerëzore në DRT Fier dhe në DPT), **është e arsyetuar** për shkak të një interesi të ligjshëm, dhe **shoqërohet nga një dokument i lëshuar nga institucioni shëndetësor**, i cili rezulton i përkthyer nga një përkthyes zyrtar i njohur nga Ministria e Drejtësisë. Nëpunësi civil ka kërkuar miratimin e pezullimit për një periudhë 3 mujore, por **nuk ka përcaktuar afatin se kur kërkon që pezullimi t'i fillojë efektet, pasi kjo është çështje që rregullohet nga dispozitat në fuqi**, konkretisht pika 11 e VKM 124/2016 e cila përcakton se kërkesa e nëpunësit civil për shkak të një interesi të ligjshëm bëhet me shkrim 15 ditë përpara datës së kërkuar për pezullim. Pra njesia përgjegjëse nuk mund t'a miratojë pezullimin pa kaluar afati 15 ditë nga momenti i administrimit të kërkesës.

Për të gjitha sa më lart, vlerësojmë se:

- Argumenti se kërkesa nuk është në respektim të afatit është i pabazuar pasi nëpunësi civil në asnjë moment nuk është shprehur se kërkon që efektet e pezullimit të fillojnë në mënyrë të menjëhershme, përkundrazi ai ka kërkuar miratimin e lejes pa të drejtë page për të mbuluar periudhën kohore të kërkesës për pezullim, siç shprehet dhe ai vetë në kërkesë, për të mos u penalizuar duke i kushtuar vendin e punës.
- Argumenti se kërkesa për pezullim e nëpunësit civil nuk vërtetohet pasi nuk është në formën e kërkuar dhe dokumenti nuk konsiderohet dokument është i pabazuar pasi, siç u shpjegua, kjo kërkesë dhe dokumentacioni shoqëruet plotësojnë të gjithë elementët e formës së kërkuar nga ligji për një kërkesë të nëpunësit civil për pezullim për shkak të interesit të ligjshëm.

Mospranimi i kërkesës së ankuesit për pezullim nga shërbimi civil, në mënyrë të vazhdueshme, edhe pse ajo është paraqitur dy herë, në formën e kërkuar nga ligji, dëshmon për një mungesë të vullnetit nga ana e organit publik, për t'i autorizuar nëpunësit civil ushtrimin e një të drejte që i njihet me ligj.

Fryma dhe qëllimi i dispozitave të posaçme të institutit të pezullimit në legjislacionin e shërbimit civil është që organi publik, përpara se të disponojë me shprehjen e vullnetit nëpërmjet vendimmarrjes, të ketë hapësirën e nevojshme për të krijuar bindjen e brendshme, nëpërmjet vërtetimit të faktit me dokumentacionin përkatës. Në rastin e institutit të pezullimit barra e provës i është ngarkuar kërkuarit, pra nëpunësit civil. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se organi publik duhet të mjaftohet me faktet e dokumentat që i parashtrihen për të disponuar me vendim në mënyrë të menjëhershme. Dispozitat e legjislacionit për pezullimin i kanë njohur njesisë përgjegjëse një afat maksimal 10 ditor për t'u shprehur në lidhje me pezullimin, afat ky i cili është lënë në dispozicion pikërisht me qëllimin që organi publik, në rastet kur ka dyshime për legjitimitetin apo bazueshmërinë e kërkesës së nëpunësit civil, të ndërmarrë vetë një proces hetimi administrativ, për të verifikuar faktet dhe rrethanat, dhe për të konkluduar me një vendimmarrje në përputhje me parimet më të larta të mirëadministrimit të veprimtarisë së administratës publike në përgjithësi dhe të shërbimit civil në veçanti. Në rastin konkret, rezulton se të dy kërkesat e nëpunësit civil për pezullim nga shërbimi civil kanë marrë përgjigje ditën e nesërme të punës. Ky reagim i organit publik, me një vendimmarrje të menjëhershme, më tepër se përgjegjshmëri, dëshmon mungesën e një hetimi të plotë administrativ për rastin.

Për më tepër, instituti i pezullimit është një institut i cili sipas ligjit nr. 152/2013 ka për qëllim ngrirjen e statusit të nëpunësit civil për një periudhë të caktuar kohore, kohë gjatë së cilës nëpunësi civil nuk përfiton pagë, sipas pikës 4 të nenit 56 të këtij ligji. Në këto kushte, vlerësojmë se miratimi i kërkesës për pezullim të ankuesit, do të ishte në interes të këtij të fundit, por edhe të institucionit, i cili gjatë periudhës që ky nëpunës është i pezulluar mund të shfrytëzojë forma e institute të tjera të njohura nga ligji (emërimi i përkohshëm, transferimi i përkohshëm) për të plotësuar përkohësisht pozicionin e ankuesit, nisur kjo edhe nga pretendimi fillestar se kërkesa nuk miratohet për arsye të ngarkesës në punë.

Për këto arsye vlerësojmë se vendimi i datës 05.02.2019 i njesisë përgjegjëse pranë DPT, për mosmiratim të kërkesës së nëpunësit civil për pezullimin nga shërbimi civil, është një vendim i pabazuar, dhe rekomandojmë që të rishikohet.

Për të gjitha sa më lart, bazuar Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 63/3, në të cilin thuhet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, neni 21/b në të cilin thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave të menjëhershme nga Drejtori i Drejtorisë Tatimore Rajonale Fier dhe Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve për miratimin e lejes pa të drejtë page për nëpunësin civil z. F.D, për një periudhë minimale prej 15 ditësh;

Marrjen e masave të menjëhershme nga njesia përgjegjëse (Drejtoria e Burimeve Njerëzore) pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për miratimin e kërkesës për pezullim të nëpunësit civil, për një periudhë 3 mujore;

Veprimet administrative për miratimin e lejes pa të drejtë page dhe të pezullimit nga shërbimi civil të koordinohen nga strukturat përgjegjëse me qëllim që të mos ketë mbivendosije.

Brenda 30 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi të njoftohemi për masat apo veprimet e ndërmarra nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Sipas nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar paraqitja e këtij rekomandimi pezullon aktet apo veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI